



Datë: 31.07.2025

Numër Protokolli: 5195/2025

A.nr.962/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.962/2025, të datës 26.05.2025 të parashtruar nga ankuesja N.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.962/2025, e datës 26.05.2025, e parashtruar nga ankuesja N.H.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile N.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 26.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me klasifikimin e vendit të saj të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.06.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa kjo e fundit më datë 12.06.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendim me numër protokolli 4642/2025, të datës 10.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.962/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3461/2025 të datës 26.05.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 14.08.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 27.03.2023; Akt emërimit me numër protokolli 01-112-30314 të datës 05.12.2013; Vendimin A.nr.362/2024 të datës 26.04.2024; Dokument

identifikimi; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.06.2025; Akt emërimit me Nr.01-112/01-0033428/25 të datës 10.06.2025; Përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me Nr.01-120/04-0080311/24 të datës 17.12.2024; Vendimin me Nr.01-020/04-0047307/24 të datës 15.07.2024; Raportin dhe propozimin për klasifikimin e vendeve të punës me numër reference 01-052/01-0074146 të datës 13.11.2024; Diplomën me Nr.297 të datës 15.08.2003; Vendimin me Nr.01/113/59169 të datës 02.07.2025; Listat e pagave të ankueses.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokolli 01-112-30314 të datës 05.12.2013, është e punësuar në pozitën e punës *Përkthyes shqip-serbisht* në Sektorin e Punëve të Përbashkëta të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Mitrovicës.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, përmes Vendimit me Nr.01-020/04-0047307/24 të datës 15.07.2024, ka themeluar Grupin e Vlerësimit për klasifikimin e vendeve të punës brenda këtij institucioni, ndërsa ky i fundit me datë 13.11.2024, ka përpiluar Raportin dhe Propozimet për klasifikimin e pozitave të punës me numër reference 01-052/010074145/24.

Si rrjedhojë, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, me Vendimin me Nr.01-120/04-0080311/24 të datës 17.12.2024, ka aprovuar Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ku sipas pikës IV të dispozitivit pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Shtojca I-Klasifikimi i Vendeve të Punës në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Ndërsa, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut në mbledhjen e mbajtur me datë 26.12.2024 ka miratuar Rregulloren Nr.02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e Administratës Komunale, ku sipas Nenit 15 pjesë përbërëse e kësaj rregullore është Lista e Klasifikimit të Pozitave për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ku pozita *Zyrtar për Përkthime, në Sektorin e Punëve të Përbashkëta të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme*, është paraparë në Kategorinë Profesionale 2, Klasa GJ35.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pozitat e përkthyesit në disa Komuna dhe Ministri është sistemuar në Klasën Profesionale 1, ndërsa edhe pse Komuna e Mitrovicës së Jugut ka miratuar klasifikimin e vendeve të punës, për të njëjtën nuk ka pasur ndryshime lidhur me klasifikimin e vendit të saj të punës apo ngritjen e koeficientit të pagës, ashtu që ankuesja me datë 23.04.2025, kishte parashtruar kërkesën me numër protokolli 01-120/04-0023495/25 tek Zyra e Personelit e organit përkatës të punësimit. Ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja nuk ka pranuar përgjigje kundrejt kërkesës së saj.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt*

heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...” e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankueses e datës 26.05.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, pasi që ankuesja ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 23.04.2025 dhe ende pa e pranuar akt emërimit rrjedhimisht para pranimit të Akt emërimit me Nr.01-112/01-0033428/25, të nënshkruar pa vërejtje nga ankuesja me datë 11.06.2025, për pozitën Zyrtar për Përkthime-Kategoria Profesional 2, KlasaGj35, të cilin akt Komuna e Mitrovicës së Jugut i ka lëshuar ankueses si rrjedhojë e klasifikimit të vendeve të punës, rezulton se e njëjta ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjegjësisht ankuesja ka parashtruar ankesë ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative ndaj kërkesës së saj dhe veprimeve kundrejt pretendimeve të saj për klasifikimin e vendit të punës.

Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të parakohshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.962/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses N.H;
- Udhëheqëses së Njëjesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Arkivit të KPMSHCK-së.